

# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **642-19-503-2-1-1**

Nr i brendshëm: **642/19/002/211**

Sa i përket tenderit për : " **HARTIMI DHE MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE PËR INVESTIME KAPITALE DHE PROJEKTEVE PËR OBJEKTE NË PRONËSI KOMUNALE** "

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**INFRA PLUS SH.P.K**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**RR.LUAN HARADINAJ SOL.1 H.1 PRISHTINË; NJËSIA LLAPNASELLË**

(Adresa)

**PRISHTINË**

(Vendi)

**10 000**

(Kodi postar)

**038 60 62 62**

(Numri Telefonit)

\_\_\_\_\_

(Numri i Faks-it)

**MUSA ISLAMAJ**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**info@inraplus-ks.com**

(Adresa elektronike)

**18/03/2019**

(Data e parashtrimit të kërkesës)



\_\_\_\_\_

(Nënshkrimi dhe vula)

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Me datë **04/03/2019** përmes platformës elektronike nga **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË** është publikuar tenderit me titull "**HARTIMI DHE MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE PËR INVESTIME KAPITALE DHE PROJEKTEVE PËR OBJEKTE NË PRONËSI KOMUNALE**" me NRP **642-19-503-2-1-1**, dhe afati për dorëzimin e ofertave ka qenë deri me datën **26.03.2019**, dhe me **06/03/2019** kemi pranuar përgjigje në kërkesën për sqarim e kërkuar nga një OE, ku është shtyer dhe afati i dorëzimit **05/04/2019**. Prandaj në afatin e rregullt kohor parashtrijmë kërkesë për rishqyrtim për faktin se kërkesat në FDT janë në kundërshtim me Ligjin dhe diskriminuese.

Në parashtrijmë ankese në afatin e rregullt kohor pasi që afati i fundit për pranimit të ofertave është data 05/04/2019.

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Kërkesa për rishqyrtim parashtrohet në përputhje me nenin 108/A të LPP-së dhe kjo parashtrihen në fazën tenderuese që do të thotë se para hapjes parashtrijmë kërkesë për rishqyrtim.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e zbatimit të aktivitetit të prokurimit me titull "" **HARTIMI DHE MBIKËQYRJA E PROJEKTEVE PËR INVESTIME KAPITALE DHE PROJEKTEVE PËR OBJEKTE NË PRONËSI KOMUNALE**" me NRP 642-19-503-2-1-1 nuk ka respektuar dispozitat Ligjit për Prokurim Publik nr. Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068, Nr. 05/L-092, dhe Udhëzuesin Operative dhe Rregulloret e Prokurimit si në vijim:

Nenin 1 të LPP-së - Qëllimi

Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

NENI 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Nenin 4 UOPP Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

Nenin 26 UOPP Kriteret e Përzgjedhjes

Neni 38 i LPP dhe Neni 56 UOPP Kontratat Kornize

Nenin 39.8 të Udhëzuesit Operativ për prokurim publik

## 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si Operator Ekonomik kemi terhequr dosjen e tenderit në platformën elektronike për të marrë pjesë në procedurën tenderuese. Gjate shqyrtimit të kritereve të kualifikimit ne kemi hasur në disa kritere si më poshtë:

**b. Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën e ATK- es të paktën këtë staf profesional (lista e ATK të dëshmojë se stafi profesional është pjesë e kompanisë të paktën nga tre mujori i parë të viti 2018 deri me tani), lista të jetë e vertetuar në ATK.**

**b.Stafi PROFESIONAL që angazhohet në Projektme**

**1(një)–Projekt. Menaxheri të jetë Ing. i Diplomuar i Ndertimtarisë min. 8 vite përvojë pune.**

**3(tre) Ing. Te Ndertimtarisë drejtimi Hidroteknike të Diplomuar ose Master min. 5 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.**

**2(dy) Ing. Te Ndertimtarisë drejtimi Hidroteknike Bachelor min. 5 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.**

2(dy) Ing. Te Ndertimtarisë drejtimi Konstruksion te diplomuar ose Master min. 8 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.

2(dy) Ing. Te Ndertimtarisë drejtimi Konstruksion Bachelor min. 5 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.

1(një)Ing. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Mekanike ose master drejtimi Komunikacioni min. 8 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.

2(dy) Ing. Inxhinier i Diplomuarne Inxhinieri Mekanike ose master drejtimi Termoteknikë dhe Termoenergjetikë min. 5 vite përvojë pune në lëmin e kërkuar pas diplomimit.

3(tre) Gjeodet te Diplo. Ose (bachelor ) min. 5 vite përvojë pune në lëmin e njejt në lëmin e kërkuar pas diplomimit. Stafi Gjeodezik i cili mund të jetë bashkëpunëtor përmes kontratës për bashkëpunim.

1(një) Oficer për menaxhim të cilësisë, bazohet në sistemin e vendosur në kompani, i cili është trajnuar dhe qertifikuar në bazë të parimeve të ISO 9001. Ky person harton raportet për menaxhimin e cilësisë. është përgjegjës të jo konformiteteve të gjetura, ti evidentoj dhe ti eliminoj ato, kontrollon aktivitetet- projektet sa i përket cilësisë.

1(një) Personel për shëndet dhe siguri në punë, bazohet në sistemin e vendosur në kompani, duke u bazuar në sistemin OHSAS 18001. Ky person përgatit raportin për sistemin OHSAS 18001 dhe për të qenë konform me kërkesat që dalin nga aspekti i sigurisë në punë.

1(një) Personel për menagjimin e sistemit të ambientit, bazohet në sistemin e vendosur në kompani, duke u bazuar në sistemin 14001.

c. Për pjesën e gjeomekanikës operatori ekonomik mund të bëjë marrveshje me ndonjë kompani të regjistruar për shqyrtime gjeomekanike.

d. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që ju i posedoni-GPS-Station Total e. Softver për projekte të infrastruktures (rrugë, ujësjellës dhe kanalizim) me licence,

Softver për përpunimin e të dhënave (Autocad) me licence Softver për Ura Auto Desk – Struktura Bridge Design (me licence).

Dëshmia a. Një listë të kontratave dhe Referenca për shërbime të lëmisë së kërkuar (Projektime) në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrat dhe Referencat duhet të korrespondojnë njëra me tjetrën .

**Dëshmia b. Një Listë e Stafit profesional për profesionet e cekura në pikën b. Duke prezantuar Diplomat, kontratat CV origjinale ose të noterizuar, si dhe dëshmi nga ATK-ja për pagesën e kontributeve të stafit të kompanisë (Original ose copje e noterizuar). Vetëm stafi i gjeodetve mund të jenë bashkëpunëtorë - Gjithashtu eksperti i certifikuar me ISO 9001, 14001 dhe 18001 duhet të jetë staf i rregullt i kompanisë e të paktën nga tre muajt e parë të vitit 2018 deri me tani), lista të jete e vertetuar në ATK.**

**-Gjithashtu eksperti i certifikuar për menagjimin e sistemit të ambientit me ISO 14001 duhet të jetë staf i rregullt i kompanisë e të paktën nga tre muajt e parë të vitit 2018 deri me tani), lista të jete e vertetuar në ATK.**

Ne si Operator Ekonomik konsiderojme se kriteri i mesiperme eshte kriter diskriminues i cili diskriminon operatoret te cilet ne realitet mund te bejne pune te mire ne rast se e fitojne tenderin por qe u pamundesohet te konkurrojne sepse kriteret nuk perkojne me proceduren e prokurimit, buxhetin e parashikuar per secilin vit kalendarik dhe proceduren e perdorur.

Autoriteti Kontraktues ne kërkesën per kapacitet teknik dhe profesional ka kerkuar qe stafi profesional te jete pjese e kompanise prej tremujorit te pare te vitit 2018 e deri me tani qe i bie se Operatori Ekonomik duhet ti kete te gjithë inxhineret pjese te kompanise per nje vit. Ne konsiderojme se kjo kerkese eshte diskriminuese duke pas parasysh faktin se nje inxhiner mund te kete pervoje pune 20 vjecare por qe nuk ka qene pjese e kompanise sipas kerkeses se Autoritetit Kontraktues dhe per kete arsye edhe pse OE eshte me se i kualifikuar te konkurroje ne kete procedure per shkak te kerkeses se mesiperme te mos i mundesohet qe te participoje ne proceduren e tenderit. Per me teper edhe institucionet publike ne rast te ndonje pune specifike e kontraktujne nje ose me shume ekspert me kontrate per pune specifike (kontrate ne veper) e cila eshte e lejuar edhe ligjin e punes. Menyra e detyrimit te operatorëve ekonomik qe ti kete staf te rregullt per periudha te gjata eshte diskriminues dhe nuk eshte menyre e sigurt qe AK të marrë vlerën për para.

Ne mendojme se kufizimet e tilla jane ne kundërshtim me Ligjin e prokurimit Neni 69 ku sipas LPP-se kerkohen kualifikimet shkollore dhe raporte (shih me poshte).

- 6.1 kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;
- 6.2 raportin për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e kaluara;
- 6.3 raportin për teknikët ose të njësitë teknike në të cilët mund të thirret kontraktuesi për zbatimin e projektit të punëve ose realizimin e aktiviteteve ndërtimore, pavarësisht se a i takojnë ose nuk i takojnë operatorit ekonomik;

Sipas nenit 51 paragrafi 1 LPP\_se Të gjitha kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar **se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale**, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji

Pra sipas Ligjit Autoriteti Kontraktues duhet te sigurohet qe Operatori Ekonomik te permbush aftesite e nevojshme profesionale dhe jo te kerkoje MAKSIMUMIN qe stafi te jete me afat te caktuar ne kuader te kompanise.

Sipas nenit 26.3 te UOPP Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Ne konsiderojme se kerkesat e AK-se qe stafi duhet te jete i punesuar per vite te caktuara nuk eshte as proporcionale as relevante per objektin e kontrates ne fjale.

Poashtu Autoriteti Kontraktues ne listen e cmimeve ka vene cmime njesi duke mos e definuar sasine indikative sipas kerkeseve te Ligjit te Prokurimit.

Neni 38 i LPP-se Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse

urdhërblertjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Poashtu sasite sipas dosjes se tenderit dhe listes se cmimeve jane ne kundershtim me UOPP neni 56.10 dhe 56.11

Autoriteti kontraktues ne sasi indiaktive ka paraqitur cmime njesi 1, qe do te thote se pragu sipas ligjit +/- 30% nuk eshte i aplikueshem ne kete rast. Ne baze te sasive formulohet edhe cmimi ofertues derisa AK-ja sipas FDT do te beje vleresimin sipas cmimit njesi duke mos ju referuar perqindjes sipas UOPP nei i siperpermendur.

Prandaj si perfundim ne kerkojme qe te behen korrigjimet sipas LPP-se dhe UOPP dhe ne kete menyre te mos diskriminohemi ne apo cdo Operator tjetere ekonomik. Nese kerkesa jone nuk merret parasysh do ti drejtohem OSHP sipas procedurave Ligjore dhe te kerkojme te drejtat tona si Operator Ekonomik.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Tani nuk mund te dihen sakt dëmet materiale sepse shpenzimet janë te inkorporuar ne projekt dhe ato rezultojë gjate fazës se përgatitjes se ofertës.

## 9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.